UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE
Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 695
Datë: 05/04/2022

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Komunikacion
Titulli i punimit	"Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Pejës"
Kandidati	Alush Kelmendi
Mentori	Prof.Dr. Beqir Hamidi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshilin e Fakultetit	Datë:
	Vendimi Nr.:

Vlerësimi i dorëshkrimit.

Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, Nr. _____ të datës _____ është formuar komisioni me këtë përbërje:

1.Prof.Dr. Ilir Doci **kryetar**
2.Prof.Dr. Beqir Hamidi **mentor**
3.Prof.assoc.Shpetim Lajqi **anëtar**

Për vlerësimin e punimit Master me titull"Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Pejës"(Analysis and simulation of roads at the entrance in the city of peja)"të kandidatit Bsc. Alush Kelmendi.
Pas kontrollimit të punimit të lartë përmendur Komisioni jep këtë:

RAPORT

Punimi me titul "Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Pejës" [Analysis and simulation of roads at the entrance in the city of peja] është hartuar në 10 kapituj dhe është ilustruar përmes 60 figurave dhe 50 tabelave.

Në kapitullin e pare: është përfshi: Pozita gjeografike e Pejës,demografia, identifikimi dhe përshkrimi i problemit të udhëkryqevë ekzistuesë dhe struktura punuesë e temës.

Në kapitullin e dytë :është prezantuar jolinetariteti i qarkullimit të automjetëve, parametrat e qarkullimit,metodat e numërimit në trafik, mënyra e mbledhjes së të dhënave të trafikut për

segmentin e analizuar të rruges së shqyrtuar në Pejë.

Në kapitullin e tretë është përfshi: bazat teorike e analizës së qarkullimit rrugor në Pejë,elementët themelore të projektimit të udhëkryqevë rrethorë ,udhëkryqet me rrethrrotullime,koncepti i udhëkryqevë me sinjalizim.

Në kapitullin e katërtështë paraqitur: Analiza e të dhënave të mbledhura për rrjetin rrugor të shqyrtuar në rrugën "Bekim Berisha ", "M9",R107", "Amir Morina" , "Rruga e Birrarisë" dhe "Ahmet Krasniqi" në Pejë dhe identifikimi i problemëve.

Në kapitullin e pestë është prezantuar: Implementimi i të dhënave të mbledhura në terren dhe futja e tyre në softuer, për të bërë modelimin dhe simulimin e rrjetit rrugor dhe nxerrjen e rezultatëve.

Në kapitullin e gjashtë është përfshi:Modelimi dhe simulimi i rrjetit rrugor për gjendjen ekzistuese,llogaritja e parametrave të qarkullimit me metodën analitike dhe të njëjtat janë future në softwer, rezultatete fituara janë paraqitur në formë të tabelave të përcjellura me grafikone.

Në kapitullin e shtatë është përfshi: Analiza e rezultateve të fituara me metodën analitike dhe softwerike.

Në kapitullin e tetë janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e kushteve të qarkullimit rrugor në bazë të analizës së rezultateve të bëra me mënyren analitike dhe sotwerit.

Në kapitullin e nëntë dhe dhjetë është prezantuar përfundimi dhe literatura për këtë temë,dhe në fund referencat.

Kandidati Alush Kelmendi nuk ka pasur praktike profesionale.

PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master,Komisioni për vlerësim konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur ,i shtjelluar përmes figurave ,tabelave dhe vizatimeve.
Prandaj ,Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Alush Kelmendi, me titull: "Analiza dhe simulimi i rrugëve në hyrje të qytetit të Pejës"

"(Analysis and Simulation of Roads at the Entrance in the City of Peja) "

Mendon se i plotëson të gjitha kriteret për punim Master,prandaj i propozon që të jepet në diskutim publik.

Prishtinë: 05 / 04 / 2022

Komisioni:

1. Prof.Dr. Ilir Doci kryetar _____
2. Prof. Dr. Beqir Hamidi mentor _____
3. Prof.asoc. Dr. Shpetim Lajqi anëtar _____

UNIVERSITETI I PRISHTINËS“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKË
DEPARTAMENTI I KOMUNIKACIONIT
STUDIMET MASTER

PUNIM DIPLOME

MASTER

Tituli i temës:

“**ANALIZA DHE SIMULIMI I RRUGËVE NË HYRJE TË QYTETIT TË PEJËS**”

Titulli itemës në anglisht:”

“**ANALYSIS AND SIMULATION OF ROADS AT THE ENTRANCE IN THE CITY OF PEJA**”

Studenti: Mentori:

Bsc .Alush Kelmendi Prof.Dr.Beqir Hamidi

Prishtinë 2022

PËRMBAJTJA

1.HYRJE 13
1.1.Pozita gjeografike 13
1.2.Demografia 14
1.3.Identifikimi dhe përshkrimi i problemit 14
1.4.Struktura punuesë e temës 15
2. NJOHURI TË PËRGJITHSHMË PËR QARKULLIMIN DHE JOLINARITETIN. 17
2.1. Njohuri të përgjithshme për qarkullimin dhe jolinearitetin 17
2.2.Madhësia apo intensiteti i qarkullimit 17
2.3.Struktura e qarkullimit 17
2.4.Dendësia e qarkullimit 18
2.5.Shpejtësia e qarkullimit 18
2.6.Variacionet sezonale dhe mujore 19
2.7.Variacionet ditore 20
2.8.Variacionet në orë 21
2.9.Variacionet brenda orës 22
3.0.Metodat e numërimit në trafik, mënyra e mbledhjes së të dhënave të trafikut për segmentin e analizuar rrugor. 23
3.BAZAT TEORIKË TË ANALIZËS SË TRAFIKUT NË RRJETIN RRUGOR NË PEJË. 26
3.1.Transporti rrugor në Pejë 26
3.2.Elementët themelorë të projektimit të udhëkryqevë rrethorë 28
3.3.Udhëkryqet më Rrethrrotullime 30
3.4.Përparësitë e rreth rrotullimëve 32
3.5.Koncepti i udhëkryqevë me sinjalizim 32
4. ANALIZA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË RRJETIN RRUGOR (NË RRUGËN "BEKIM BERISHA"E CILA LIDHË 3 UDHËKRYQET PËR SHQYRTIM) TË SHQYRTUAR DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMËVE. 34
4.1.Udhëkryqi(U3) rrethor i rrugëve "M9", "Bekim Berisha" , "Rruga e Birrarisë" dhe rruga "Amir Morina" 34
4.2. Udhëkryqi (U2) i rrugëve "Bekim Berisha " dhe "Ahmet Krasniqi" 35
4.3. Udhëkryqi i rrugëve "R107" "Bekim Berisha " dhe rruga Dedë Krasniqi" 35
5. IMPLEMENTIMI I TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË UDHËKRYQE DHE FUTJA E TYRË NË SOFTUERIN SYNCHRO 10.0 41
5.1 Softueri i përzgjedhur për analizë (Synchro 10.0). 41

5.2. Të dhënat për qarkullimin e automjetëve në segmentin rrugorë të mbledhura në terren 42
5.3. Mënyra e numërimit dhe e mbledhjes së të dhënave 43
6.MODELIMI DHE SIMULIMI I RRJETIT RRUGOR MË SOFTUER SYNCHRO 10.0...52
6.1. Kapaciteti dhe niveli i shërbimit 52
6.2. Niveli i shërbimit 53
6.3. Llogaritja e parametrave të qarkullimit për gjendjen ekzistuesë 55
6.4 Modelimi dhe parametrat e qarkullimit për gjendjen ekzistuesë 55
6.5.Llogaritja e nivelit të shërbimit sipas HCM në mënyrë analitike për udhëkryqin U3 .56
6.6.Udhëkryqi i dytë U3 dhe gjendja ekzistuesë....56
6.7.Llogaritja e kapacitetit për hyrjet e udhëkryqit dhe rrethrrotullimit bëhet më shprehjën e më poshtmë 58
Llogaritja e kapacitetit për hyrjet përkatëse....59
6.8.Llogaritja e shkallës së ngopjes: 60
6.9.Humbjet mesatarë kohorë 61
6.10.Llogaritja e numrit të automjetëve në radhë 63
6.11.Llogaritja e humbjevë të përgjithshmë mesatarë kohorë për udhëkryqin rrethor për gjendjen ekzistuesë për udhëkryqin U3 hyrjet (H1,H2,H3,H4)....67
6.12.Llogaritja e nivelit të shërbimit me anë të softuerit Synchro për udhëkryqin U3 (gjendja ekzistuesë)....68
6.13.Paraqitja tabelare e nivelit të shërbimit të udhëkryqit U3 në menyrë analitike dhe me Sim Trafik,dhe krahasimi i tyrë. 73
6.14. Llogaritja e nivelit të shërbimit për udhëkryqin U2 (gjendja ekzistuesë)....74
6.14.Llogaritja e kapacitetit potencial dhe nivelit të shërbimit të shiritit për kthim majtas nga rruga kryesore q_2: 75
6.15.Llogaritja e kapacitetit potencial dhe të nivelit të shërbimit të shiritit të përbashkët për kthim djathtas dhe majtas nga rruga dytësore q3....76
6.16.Llogaritja e kapacitetit potencial dhe nivelit të shërbimit të shiritit për kthim majtas nga rruga dytësore q3: 77
6.17.Llogaritja e humbjevë të përgjithshme mesatarë kohorë për tërë udhëkryqin....78
6.18.Në vashdim rezultatet e llogaritura analitikisht do ti prezantojm edhe përmes softuerit Sim Trafik për udhëkryqin U2....78
6.19.Paraqitja tabelare e nivelit të shërbimit të udhkryqit U2 në menyrë analitike dhe me Sim Traffic,dhe krahasimi i tyre. 80
6.20.Udhëkryqi i parë U1 gjendja ekzistuesë 81

6.21.Llogaritja e kapacitetit për hyrjet e udhëkryqit me rrethrrotullimit bëhet më shprehjën e më poshtmë 83
6.23.Humbjet mesatarë kohorë 85
6.24.Llogaritja e numrit të automjetëve në radhë 86
6.25.Llogaritja e humbjevë të përgjithshme mesatare kohorë për tërë udhëkryqin U1 hyrjet (H1,H2,H3) 88
Fig.6.9:Definimi i shiritave për udhëkryqin U1 89
7. ANALIZA E REZULTATËVE TË FITUARA PËR PARAMETRAT KRYESOR TË RRJETIT RRUGOR 93
8.PROPOZIMET KONKRETË LIDHUR MË UDHËKRYQET E ANALIZUARA 94
8.1.Paraqitja e udhëkryqit ekzistues (U2) që lidhë rrugët Ahmet Krasniqi dhe Bekim Berisha 94
8.2.Propozimi i udhëkryqit U2 me sinjalizim nga forma ekzistuesëe formës T. 95
8.3.Të dhënat hyrëse për udhëkryqin U2 97
8.4.Llogaritjet e detyrës 99
8.5.Krahasimi i rezultatëve të udhëkryqit U2 të propozuar në menyrë analitike dhe me softuerin Sim Trafikut. 105
8.6.PROPOZIMI PËR UDHËKRYQIN U3 QË LIDHË RRUGET (″M9″″BEKIM BERISHA ″RRUGEN E ″BIRRARISË ″DHE″AMIR MORINA″). 106
8.7.Llogaritja e nivelit të shërbimit për udhëkryqit U3(propozimi) dhe krahasimi i rezultatëve në menyrë analitike dhe me sim trafik. 110
8.8.Llogaritja e kapacitetit për hyrjet e udhëkryqit me rreth rrotullim bëhet me shprehjën e më poshtmë. 112
Llogaritja e kapacitetit për hyrjet përkatës 112
8.9.Llogaritja e shkallës së ngopjes: 113
8.10.Humbjet mesatarë kohorë 114
8.11.Llogaritja e numrit të automjetëve në radhë 115
8.12.Llogaritja e humbjeve të përgjithshme mesatare kohore për tërë udhëkryqin U3 për hyrjet H1,H2,H3,H4 117
8.13.Llogaritja e humbjevë të përgjithshme mesatare kohore për tërë udhëkryqin U3 për hyrjet H4,H5, e propozuar (rruga Amir Morina) 117
8.14.PROPOZIMI PËR UDHËKRYQIN E PARË U1 121
9.PËRFUNDIM 123
10.LITERATURA 124
DEKLARATË E STUDENTIT PËR PUNË ORIGJINALE 126

Lista e figurave

Fig.1.2.Pozita gjeografike e qytetit të Pejës(Burimi:Gjeoportal Kosova) 13
Fig.1.3:Udhëkryqet për shqyrtim në segmentin rrugor (Burimi: Gjeoportal Kosova).15
Fig.2.1:Shpejtësia e qarkullimit 19
Fig.2.2:Qarkullimi në përqindje (%) të trafikut javorë 21
Fig.2.3:Qarkullimi në orë.....21
Fig.2.4:Qarkullimi në orë.....23
Fig.2.5:Formulari i numërimëve në trafik.....24
Fig.3.1:Plani zhvillimore komunal i komunes së Pejës[Burimi:Komuna e Pejë].....26
Fig.3.2:Zonat e qytetit bazuar në analizën e transportit (Burimi:Komuna e Pejës).....27
Fig.3.3:Distanca e dukshmërisë(pamjes) 29
Fig.3.4:Elementët gjeometrike të udhëkryqëve rrethorë.....31
Fig.3.5:Veçoritë e përmasave gjeometrike të udhëkryqevë rrethorë 31
Fig.3.6: Pikat konfliktoze.....32
Fig.3.7:Zgjedhja e tipit të udhëkryqit sipas rekomandimëve të institutit Kommunförbundet. 33
Fig.4.1: Rruga “M9” me rrugët“ Bekim Berisha ”Amir Morina dhe “Rrugën e Birrarisë”(Burimi: Google Maps) 34
Fig.4.2: Rruga “ Bekim Berisha ”me rrugën “Ahmet Krasniqi”(Burimi:Google Maps) 35
Fig.4.3:Rruga “R107” me rrugën“ Bekim Berisha dhe Ded Krasniqi”(Burimi:Google Maps) 36
Fig.4.4:Mungesa e sinjalizimit horizontal –vija e plotë rruga Ahmet Krasniqi.....37
Fig.4.5:Mungesa e vendkalimëve të shënuar për këmbësorë të udhëkryqet e analizuar 38
Fig.4.6:Gjendja ekzistuese e vendkalimëve të këmbësorevë.....39
Fig.4.7:Automjetët e parkuara në vende të ndaluara 39
Fig.4.8:Automjetët e parkuara në vende të ndaluara dhe në trotuar 40
Fig.5.0:Karakteristikat e marrura në trajtim[],[] 42
Fig.5.1:Pikat hyrëse në rrjetin rrugor të trajtuar(Burimi:Gjeoportal Kosova) 43
Fig.5.2: Numërimet për ditën e hënë 44
Fig. 5.3:Numërimet për ditën e martë.....45
Fig.5.4:Numërimet për ditën e mërkurë.....46
Fig. 5.5:Numërimet për ditën e enjtë 47
Fig.5.6:Numërimet për ditën e premtë.....48

Fig.5.7:Numërimet për ditën e shtunë.....49
Fig.5.8:Numërimet për ditën e dielë 50
Fig.5.9: Jolineariteti javorë 51
Fig.6.1: Synchro 10.0.....55
Fig.6.2: Definimi i shiritavë të udhëkryqit U3 dhe hyrjevë.....56
Fig. 6.3: Gjendja ekzistuesë e rrethrrotullimit i paraqitur me SimTrafik 68
Fig.6.4. Paraqitja përmes auto cadit i udhëkryqitU3 dhe hyrjet. 68
Fig.6.5:Udhëkryqi U3 përmes Synchros dhe niveli i shërbimit për të gjitha hyrjet 70
Fig.6.6: Gjendja ekzistuesë e udhëkryqit të dytë 74
Fig.6.7:Paraqitja e udhëkryqit U2 me anë tësoftuerit Sim Trafik.....78
Fig.6.8: Gjendja ekzistuese e rrethrrotullimit U1 i paraqitur me Auto Cad 81
Fig.7.1: Humbjet kohorë.....93
Fig.8.1: Paraqitja e udhëkryqit ekzistuesë U2 në mes rrugëve“Ahmet Krasniqi dhe Bekim Berisha”.....94
Fig.8.2: Paraqitja e udhëkryqit ekzistuesë U2 në mes rrugëve“Ahmet Krasniqi dhe Bekim Berisha” me SimTrafik.....95
Fig.8.3:Udhëkryqi U2 me sinjalizim propozimi vizatuar me Auto Cad.....95
Fig.8.4:Udhëkryqi U2 me sinjalizim propozimi 3D SimTrafik.....96
Fig.8.5: Të dhënat për udhëkryqin e propozuar U2 me sinjalizim ndriques me softuerin Sim Trafik.....103
Fig.8.6: Udhëkryqi ekzistues U3 106
Fig.8.7:Paraqitja e udhëkryqit U3 përmes softuerit Auto Cad ,gjendja ekzistuesë dhe propozimi.....107
Fig.8.8:Paraqitja e udhëkryqit ekzistuesë U3 me Sim Trafik. 107
Fig.8.9: Paraqitja e propozimit për udhëkryqin U3 me Sim Trafik.....108
Fig.8.10:Paraqitja e propozimit për udhëkryqin U3 më Auto Cad. 109
Fig.8.12: Propozimi për udhëkryqin ekzistues U3 në 3D me Synchro10.....109
Fig.8.13:Paraqitja e propozimit për udhëkryqin ekzistues në 3D me SimTrafik.....110
Fig.8.14:Propozimi për udhëkryqin U3 me Auto Cad.....110
Fig. 8.15:Paraqitja e nivelit të shërbimit për udhëkryqin U3 me Sim Trafik-propozimi. 117
Fig. 8.16: Gjendja ekzistuesë e udhëkryqit U1. 121
Fig.8.17: Udhëkryqit U1 i paraqitur përmes Auto Cadit me sinjalizim horizontal dhe vertikal. 122
Fig.8.18: Niveli i shërbimit për udhkryqin U1(Rruga R107 , Bekim Berisha ,Dedë Krasniqi) përmes Sim Trafikut. 122

Lista e tabelave

Tab.5.1: Orari i numërimevë.....42
Tab.5.2: Numërimet fillestare për ditën e hënë.....44
Tab.5.3:Numërimet fillestare për ditën e martë.....45
Tab.5.4: Numërimet fillestare për ditën e mërkurë.....46
Tab.5.5: Numërimet fillestare për ditën e enjtë.....47
Tab.5.6: Numërimet fillestare për ditën e premtë.....48
Tab.5.7: Numërimet fillestare për ditën e shtunë.....49
Tab.5.8: Numërimet fillestare për ditën e dielë.....50
Tab.5.9: Numri total i automjetëve gjatë ditëve të javës.....51
Tab.6.1*: Niveli i shërbimit për udhëkryqet me sinjalizim dhe pa sinjalizim*..... 54
Tab.6.2*:Të dhënat e qarkullimit për hyrjet e udhëkryqit U3dhe ekuivalentimi i mjetëve transportuesë në aut/h për diten më të ngarkuar e Hënë ora 7:00-8:00*.....57
Tab.6.3:Llogaritja e qarkullimëve konfliktuoze për secilën hyrje [5],[7].....58
Tab.6.4:Paraqitja e nivelit të shërbimit sipas manualit amerikan të rrugëve HCM-së 65
Tab.6.5:Ekuivalentimi i automjetëve 65
Tab.6.6:Humbjet mesatare kohorë.....66
Tab.6.7: Paraqitja e rezultatëve të nivelit të shërbimit, shkallës së ngopjes dhe numërit të automjetëve në radhë 66
Tab.6.8: Paraqitja e nivelit të shërbimit të udhëkryqit U3 për hyrjet (H1,H2,H3,H4). 69
Tab.6.9:Paraqitja e volumit dhe definimi i shiritave të udhëkryqit U3 për hyrjet (H1,H2,H3,H4). 69
Tab.6.10:Paraqitja e nivelit të shërbimit të udhëkryqit U3 tëHyrjes H5me HyrjenH4(Rrugen M9).....70
Tab.6.11:Paraqitja e volumit dhe definimi i shiritave të udhëkryqit U3 për hyrjet (H5dhe ..71
Tab.6.12:Paraqitja e nivelit të shërbimit të udhëkryqit U3 për hyrjen H6(Amir Morina)dhe hyrjenH1(Bekim Berisha).....72
Tab.6.13.Paraqitja e volumit dhe definimi i shiritave të udhëkryqit U3 për hyrjet 73
Tab.6.14: Llogaritja analitike.....73
Tab.6.15:Llogaritja me softwerin Sim Trafik. 74
Tab.6.16: Ekuivalentimi i mjetëve transportuesë në aut/h.....75
Tab.6.17:Paraqitja e volumit dhe definimi i shiritave të udhëkryqit U2 për hyrjet(H1,H2,H3) 79
Tab.6.18:Llogaritja analitike.....80
Tab.6.19:Llogaritja me Sim Traffik.....80

Tab.6.20:Ekuivalentimi i mjetëve transportuesë në aut/h.....82
Tab.6.21:Llogaritja e qarkullimëve konfliktuoze për secilën hyrje 82
Tab.6.22: Rezultatët e llogaritjevë te nivelit të shërbimit, shkallës së ngopjes dhe numërit të automjetëve në radhë. 88
Tab.6. 23.Definimi i shiritave në udhëkryqinU1 89
Tab.6.24:Volumi i automjetëve në udhëkryqinU1 (H1,H2,H3,)dhe niveli i shërbimit me sim trafik.....90
Tab.6.25:Paraqitja e niveli të shërbimit, humbjevë kohore me SimTraffic për udhëkryqinU1(H1,H2,H3,) 90
Tab.6.26:Paraqitja e niveli të shërbimit, definimi i rreshtave me SimTraffic të udhëkryqit U1 (H4,H5,H6) 90
Tab.6.27: Llogaritja *analitike* 92
Tab.6.28: Llogaritja me Sim Trafik 92
Tab.7.1:Niveli i sherbimit dhe humbjeve kohore (llogaritur analitikisht)…….. 93
Tab.8.1:Të dhënat e udhëkryqit ……. 97

Tab.8.2:Llogaritja analitikisht e udhëkryqit U2[] 99
Tab.8.3:Vonesat kohore dhe niveli i përgjithshme për udhëkryqin U2 me Sim Trafik.....104
Tab.8.4: Rezultatët në formë tabelare për udhëkryqin U2 përmes Sim Trafikut.....105
Tab.8.5: Rezultatët në formë tabelare për udhëkryqin U2 në menyrë analitike. 105
Tab.8.6:Të dhënat e udhëkryqit ekzistuesë U3. 111
Tab.8.7: Qarkullimet konfliktuoze për secilën hyrje për udhëkryqin U3 [3]. 111
Tab.8.8: Paraqitja e nivelit të shërbimit për udhëkryqin U3 në përgjithësi dhe hyrjeve(H1,H2,H3,H4) me Sim Trafik. 118
Tab.8.9: Paraqitja e shiritave dhe volumit të automjetëve për udhëkryqin U3 për hyrjet (H1,H2,H3,H4) me Sim Trafik. 118
Tab.8.10: Paraqitja e volumit të automjetëve për udhëkryqin U3 për hyrjet (H5,H6,) me Sim Trafik(rruga Bekim Berisha dhe Amir Morina).....119
Tab.8.11: Paraqitja tabelarë e rezultatëve të udhëkryqit U3 me Sim Traffic(propozimi) 120
Tab.8.12: Paraqitja tabelarë e rezultatëve të udhëkryqit U3 analitikisht(propozimi). 120

1.HYRJE

1.1.Pozita gjeografike

Komuna e Pejës gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës, ndërmjet koordinatave gjeografike: 42°39'00"N dhe 20°18'00"E, 86 km në perëndim të Prishtinës, në një lartësi mbidetare 505 – 520 m. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës është 603 km², që e bën atë komunën e tretë më të madhe në Kosovë për nga sipërfaqja.

Në pjesën jugore kufizohet me Deçanin me fshatrat: Lubeniq, Zllapek, Krushec, Broliç Kotradiq, Vranoc, Buqan, Gllogjan, Nepole. Në pjesën lindore që përfshin sipërfaqen e rrugës Pejë - Prishtinë kufizohet me fshatrat: Jabllanica e Leshanit, Sverka, Tërsteniku. Në pjesën verilindore kufizohet me fshatrat: Ruhot, Osoje. Në pjesën e rrugës që lidh Pejën me Mitrovicën kufizohet me fshatrat: Ozdrim, Dubovë. Në pjesën veriore kufizohet me fshatrat: Jabllanica e Vogël dhe Jabllanica e Madhe Në pjesën veri perëndimore kufizohet me Malin e Zi. [1]

Fig.1.1.Pozita gjeografike e qytetit të Pejës(Burimi:Gjeoportal Kosova)

1.2.Demografia

Në vitet e pas luftës mungesa e infrastrukturës, largësia nga qendrat arsimore,shëndetësore, kulturore etj, kanë ndikuar në migrimin e madh të popullsisë prej viseve rurale në atë urbane, po ashtu në dendësinë e popullsisë ka ndikuar konflikti i fundit sepse shkatërrimet e shtëpive që janë bërë në fshatra i kanë detyruar familjet të gjejnë strehim në qytet, për shkak të pamundësive për rindërtimin e tyre.

Komuna e Pejës, përfshinë një hapësirë prej 603km², sipas regjistrimit të bërë Peja ka diku afër 140.000-160.000 banorë, 51% meshkuj. (58% jetojnë në zonat urbane). Dendësia e popullsisë është e madhe,me rreth 300 banorë në 1km².

Parashikimi demografik për të ardhmen është llogaritur duke analizuar vlerat e rritjes së popullsisë sipas regjistrimevë zyrtare, rrethanat që ndikuan në ngritje apo rënie, si dhe të dhënat nga Agjensia e statistikave të Kosoves mbi shtimin natyror si komponenti themelor që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen demografike. Bazuar në këto të dhëna, është bërë përcaktimi i shkallës vjetore të shtimit natyror të popullsisë në komunën e Pejës gjatë periudhës 2011-2017, që është saktësuar në 0.9% ose 950 banorë për çdo vit. Në mungesë të informatave zyrtare për migrimet, këto të fundit nuk janë pjesë e kalkulimeve. [1]

1.3.Identifikimi dhe përshkrimi i problemit

Trafiku rrugor në qytetin e Pejës ballafaqohet me probleme të tilla siç janë*:* numri shumë i madh i automjetëve, rrjeti rrugor është i pamjaftueshëm për ti përballuar këto kërkesa,rrugët e ngushta, pamundësia për zgjerimin e rrjetit rrugor, numri i madh i këmbësorëve etj.

Në këtë punim diplome, do të bëhet shqyrtimi i 3 udhëkryqeve në qytetin e Pejës, të cilet lidhin rrjetin e rrugëve: Rrugen "M9'', Rruga "R107", "Rrugen Bekim Berisha" , Rrugen "Ahmet Krasniqi",Rrugen˝Amir Morina˝ dhe Rugen e ˝Birrarisë˝(Fig.1.3.) me qëllim identifikimin e problemëve të trafikut në këto udhëkryqe dhe propozimin për zgjidhje të mundshme.

Fig.1.2:Udhëkryqet për shqyrtim në segmentin rrugor (Burimi: Gjeoportal Kosova).

1.4.Struktura punuesë e temës

Ky punim i masterit përfshinë tetë kapituj nga gjithësejt dhjetë kapituj, në kapitullin e nëntë dhe dhjetë është paraqitur përfundimi dhe literatura e shqyrtuar për këtë punim. Në vijim do të prezantojmë strukturen punuesë për secilin kapitull.

Në **kapitullin e parë** -është përfshi: Pozita gjeografike e pejës,demografia, identifikimi dhe përshkrimi i problemit të udhëkryqevë ekzistuesë dhe struktura punuesë e temës.

Në **kapitullin e dytë-**është prezantuar jolinetariteti i qarkullimit të automjetëve, parametrat e qarkullimit,metodat e numërimit në trafik, mënyra e mbledhjes së të dhënave të trafikut për segmentin e analizuar të rruges së shqyrtuar në Pejë.

Në **kapitullin e tretë-**është përfshi: bazat teorike të analizës së qarkullimit rrugor në Pejë, parametrat e qarkullimit,elementët themelorë të projektimit të udhëkryqevë rrethorë dhe përparsit e tyre,koncepti i udhëkryqevë me sinjalizim.

Në **kapitullin e katërt-**është paraqitur: analiza e të dhënave të mbledhura për rrjetin rrugor të shqyrtuar në rrugën “Bekim Berisha ”, “M9”,R107”, “Amir Morina” , “Rruga e Birrarisë” dhe “Ahmet Krasniqi” ,Dedë Krasniqi në Pejë dhe identifikimi i problemëve.

Në **kapitullin e pestë** -është prezantuar implementimi i të dhënave të mbledhura në terren dhe futja e tyre në softuer, për të bërë modelimin dhe simulimin e rrjetit rrugor dhe nxerrjen e rezultatëve.

Në **kapitullin e gjashtë** -është përfshi::modelimi dhe simulimi i rrjetit rrugor përgjendjen ekzistuesë,llogaritja e parametrave të qarkullimit me metodën analitike dhe të njëjtat janë future në softwer, rezultatet fituara janë paraqitur në formë të tabelave të përcjellura më grafikone.

Në **kapitullin e shtatë** -është përfshi: analiza e rezultatëve të fituara me metodën analitike dhe softuerike.

Në **kapitullin e tetë**-janë dhënë rekomandimet për përmirësimin e kushtëve të qarkullimit rrugor në bazë të analizës së rezultateve të bëra me mënyren analitike dhe softuerit.

Në **kapitullin e nëntë dhe dhjetë** -është prezantuar përfundimi dhe literatura për këtë temë.

2. NJOHURI TË PËRGJITHSHMË PËR QARKULLIMIN DHE JOLINARITETIN.

2.1. Njohuri të përgjithshme për qarkullimin dhe jolinearitetin

Qarkullimi në komunikacion definohet si kolonë e automjetëve, të cilat qarkullojnë në ndonjë aks rrugor,në një drejtim,me shpëjtesi që është madhesi e rastësishme e ndryshuar dhe në distancë të caktuar ndërmejt tyre. [3]

Qarkullimi trafikor posedon në vehtë disa karakteristika,ndër të cilat janë:

2.2.Madhësia apo intensiteti i qarkullimit

Madhësia apo intensiteti i qarkullimit shpreh numrin e automjetëve të matura në një interval të caktuar më parë kohor, që lëvizin në një drejtim nëpër prerje apo seksion të caktuar të aksit rrugor. [3]

Njësitë më të shpeshta të kohes,më të cilat shprehet qarkullimi jane:

- **Dita(Qd,aut/24h),**
- **Ora(Q,aut/h),**
- **Intërvali 15 minuta(Q15,aut/15min) dhe**
- **Intërvali 5 min (Q5,aut/5min).**

2.3.Struktura e qarkullimit

Struktura e qarkullimit paraqet pjesëmarrjen në përqindje të kategorive themelore të automjetëve në numër, respektivisht intensitetin e gjithmbarshëm të qarkullimit. [3]

Struktura e qarkullimit më së shpeshti shprehët nëpërmjet këtyre kategorive të automjetëve:

– Automjetët e udhëtarëve (AU),

– Autobusët (BUS)

– Automjetët e lehta transportuesë (ALT),

– Automjetët gjysmë të rënda transportuesë (AGjRT),

- Automjetët e rënda transportuesë (ART),
- Autotrenat (AT),
- Tramvajet me rimorkio (TR),
- Mopedët (MP),
- Motoçikletat (MC).

2.4.Dendësia e qarkullimit

Densiteti i qarkullimit paraqet numrin momental të automjetëve në komunikacion të cilat qarkullojnë në njësi të gjatësisë së rrugë dhe është: [7]

$$g=\frac{N[aut]}{s[km]} \qquad (2.1)$$

ku janë shënuar me:

N(aut) - numri i automjetëve në qarkullimin e komunikacionit në pjesën e shikuar të rrugës në momentin e caktuar.

s (km) -gjatësia e pjesës së rrugës e shprehur në kilometra.

2.5.Shpejtësia e qarkullimit

Për nevoja të një analize teorike të ligjshmërisë së qarkullimit në komunikacion definohen këto llojë të shpejtësive: [3] [7]

a) Shpejtësia mesatare hapësinore (Vh) e cila paraqet mesataren e shpejtësive të automjetëve që ngasësin në gjatësi (L) të dhënë të rrugës.

Kjo shpejtësi ndryshe quhet edhe shpejtësia e qarkullimit,

$$V_{\square} = \frac{1}{n}\frac{L}{\sum_{i=1}^{n} ti} \qquad (2.2)$$

n- është numri i automjetëve në njësi të gjatësisë së rrugës.

Në figurën 2.1. është prezantuar në formë ilustrative shpejtësia mesatare dhe hapësinore e automjetit.



Fig.2.1:Shpejtësia e qarkullimit

– Shpejtësia mesatarë kohore e cila paraqet shpejtësinë mesatare aritmetike të të gjitha automjetëve të qarkullimit në komunikacion të cilët e kalojnë pjesën e caktuar të rrugës në periudhë të caktuar kohore,

$$V_h = \frac{1}{N} \sum_{i=1}^{N} v_j \quad (2.3)$$

2.6.Variacionet sezonale dhe mujore [2]

Ndryshimet sezonale në flukset e trafikut përkufizohen si raporti i fluksit mesatar ditor për çdo muaj me fluksin mesatar vjetor. Karakteristikat e variacionevë sezonale në vëllimet e trafikut përdoren për një sërë qëllimesh, për shembull për të përcaktuar parametrat bazë që përshkruajnë trafikun mesatar ditor vjetor , vëllimin për orë, analizat e besueshmërisë së rrjetit rrugor dhe menaxhimin e trafikut. Disa prej karakteristikave më të rëndësishme të variacionevë sezonale janë: [2]

– Variacionet sezonale janë më të theksuara gjatë periudhës dimërore,

– Variacione mujore janë më të theksuara gjatë ndryshimeve të kushtëve atmosferike,

– Variacione mujore janë më të theksuara gjatë periudhës vjeshtë-dimër,

– Variacione mujore janë më të theksuara në rrugët rurale sesa në rrugët urbane apo ndërurbane. [2]

Qarkullimi mujor llogaritet me shprehjen:

$$q_m = \frac{\sum_{j=1}^{n} q_{dj}}{n} \qquad (2.4)$$

Ku janë:

q_{jm} – paraqet qarkullimin mesatar i matur në çdo ditë të muajit (aut/muaj)

q_{dj} – paraqet qarkullimi mesatar ditor për periudhën e një muaji të matur (aut/ditë)

n – numri i ditëve të muajit

2.7.Variacionet ditore [2]

Variacionet ditore të vëllimit në varësi nga variacionet e javës janë të lidhura me llojin e rrugës në të cilën janë bërë vëzhgime. Në figurën 2.2 është treguar vëllimi javor i qarkullimit të automjeteve ku lehte mund te shihet se qarkullimet e automjeteve në fundjavë janë më të ulëta se sa vëllimet në ditë pune për rrugët dhe autostradat që shërbejnë kryesisht për udhëtime të biznesit, të tilla si rrugët urbane. Në krahasim me këtë, ora kulmore e trafikut ndodhë gjatë fundjavës në rrugët lokale, rurale dhe rekreative. [2]



Fig.2.2:Qarkullimi në përqindje (%) të trafikut javorë

2.8.Variacionet në orë

Modelet tipike të variacioneve në çdo orë janë treguar në figurën 2.3, ku modelet kanë të bëjnë me llojin e rrugës urbane të ngarkuar sipas orëve të ditës. Në figurën 2.3 është paraqitur qarkullimi i trafikut i matur në një rrugë të Prishtinës me dy shirita (korsi), në një drejtim të lëvizjes për tri ditë të javës: e martë, e shtunë, e dielë .[2]



Fig.2.3:Qarkullimi në orë

$$q_d = \frac{\sum_{j=1}^{24} q_j}{24} (2.5) \qquad (2.5)$$

Ku janë:

q_j – qarkullimi mesatar i matur në çdo orë të ditës (aut/h)

q_d – qarkullimi në periudhën 24 orë (aut/ditë)

2.9.Variacionet brenda ores [2]

Parashikimet e vëllimit për studime afatgjata janë shprehur shpesh në terma të AADT (automjete në ditë), dhe më pas reduktohen në vëllim të orëve. Analiza e nivelit të shërbimit (ang.Level of Service – LOS) është e bazuar në shkallët e pikut të qarkullimit që ndodhin brenda orës së pikut. Në fig.2.4 janë treguar luhatjet e ndryshme 15 minutëshe të qarkullimit që mund të paraqiten brenda një ore. Grafiku është paraqitur në çdo 15 minuta interval kohor në orën e pikut – 07:00-09:00.

Nga fig.2.4, shkalla maksimale e qarkullimi është 500 aut/h, derisa shkalla maksimale e qarkullimit për orë është 440 aut/h (me vija të ndërprera). Dizajnimi i rrugës bazuar në shkallën 15 min mund të rezultojë në ngirjte të kapacitetit krahasuar me pjesën tjetër të orës së pikut.

Dizajnimi për vëllimin e orës së pikut mund të rezultojë në kushte të qarkullimit të mbingopur për pjesën të qarkullimit në orë. Marrja parasysh e këtyre vlerave kulmore është e rëndësishme. Tollovitë e shkaktuara për shkak të kapacitetit joadekuat që paraqiten vetëm për disa minuta mund të marrin një kohë të gjatë që të shpërndahen për shkak të dinamikës së rrjedhjes së qarkullimit. Relacioni në mes të shkallës 15-minutëshe të qarkullimit dhe vëllimit të orës së plotë është dhënë me *Faktorin e Orës Kulmore (FOK),* ose në ang. *Peak-hour factor* (PHF). Ky faktor aplikohet për të përcaktuar shkallët e qarkullimit në orë. [2]

Llogaritja e PHF faktorit bëhet me formulën:

$$PHF = \frac{q}{4q_{\max}^{15}} \tag{2.6}$$

Ku janë:

q (aut/h) – qarkullimi i matur në një orë,

q_{max}^{15} – qarkullimi i matur në çdo 15 min.



Fig.2.4:Qarkullimi për qdo 15 min

3.0.Metodat e numërimit në trafik, mënyra e mbledhjes së të dhënave të trafikut për segmentin e analizuar rrugor.

Inçizimi ,respektivisht numërimi në komunikacion ,është bazë e planifikimit të qarkullimit në trafik.

Inqizimi i qarkullimit ,respëktivisht mbledhja e të dhënave mbi qarkullimin në trafik,është e nevojshmë për shkak të: [3]

- Planifikimit në trafik dhe atij urbanistik,
- Planifikimit të përspektives së rrjetit në komunikacion për një rajon më të vogel apo më të madhe apo formimit të ndonje nyje eventuale në komunikacion.
- Rekonstruimëve eventuale të rrjetit ekzistues të komunikacionit dhe rindertimit eventual të drejtimevë të reja.

Në praktik dallohen dy llojë të numrimit: [3]

a) Numrimi statik ,respektivisht numrimi i trafikut në ndonjë prerjë,

b) Numrimi dinamik,respektivisht numerimi i qarkullimit në komunikacion

Ekzistojne shumë metoda të inqizimëve ,ndër të cilat do ti numrojmë: [3]

-Metoda e shenimit në formulare

-Metoda e regjisrimit të shenjave të regjisrimit,

-Metoda e shenimëve nëpërmjet tiketave

-Metoda e ekzaminimeve të rruges,

-Metoda e shenjave të numerimit,

-Metoda elektromekanike sipas Prädel(Predel-it) etj.

FORMULARI

INÇIZIMI NË TRAFIK

Punkti numërues (udhëkryqi):---------------
Drejtimi i numërimit:--------------------------
Kushtet meteorologjike:---------------------
Data dhe dita e inçizimit :--------------------

Nr.i fletës: --------------
Vendi I nr:--------------
Koha e nr:--------------

Drejtimi								Të tjerat
					L	M	R	

NUMRUESI:
KONTROLLOI:
VËREJTJE:

Fig.2.5:Formulari i numërimëve në trafik[3]

Në bazë të numërimëve të realizuara për të gjitha llojet e mjetëve transportuesë janë ekuivalentuar përmes ekuivalentimit i cili zbatohet për të gjitha kategoritë e mjetëve dhe është nxjerr një numër të përbashkët për numrin e mjetëve në secilin shirit të udhëkryqevë. [8]

Numri i automjeteve = 0.5 M ·1A ·2K (2.7)

ku janë shënuar me:

M - Motoçikleta

A - Automjetët e udhëtarëve

K – Kamionë

3.BAZAT TEORIKË TË ANALIZËS SË TRAFIKUT NË RRJETIN RRUGOR NË PEJË.

3.1.Transporti rrugor në Pejë

Transporti shprehë një aktivitet shumë të rëndësishëm të njerëzimit. Ai është pjesë e e rëndësishmë e ekonomisë dhe luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis lokalitetëve. Transporti në Pejë kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike, si dhe transporti përmes hekurudhës, i cili është pothuajse simbolik. Rrjeti i rrugëve nacionale dhe rajonale (M9, R-106, R-107, R-101) janë në gjatësi prej 103km, dhe rrugët lokale në gjatësi prej 780km .Aktualisht, deri në vitin 2018, komuna e Pejës ka rregulluar 600 km gjatësi të rrugëve lokale, ndërsa 150 km kanë mbetur të parregulluara. [1]

Fig.3.1:Plani zhvillimorë Komunal i Komunes së Pejës[Burimi:Komuna e Pejës][1]

Qyteti është ndarë në katër zona për analizë të sfidavë dhe mundësive në planifikim të transportit të qëndrueshëm: [1]

zona 1 – Qendra e qytetit- Korza;

zona 2 – Shërbimet tregtare**;**

zona 3 - Banimi; dhe

zona 4 – Industria dhe biznesi.



Fig.3.2:Zonat e qytetit bazuar në analizën e transportit (Burimi:Komuna e Pejës)

Zona 1:Qendra e qytetit – Korzo –Dendësia relativisht e madhe e objektëve për banim, funksionet e kombinuara publike dhe private e kanë bërë të pamundur për komunën që të ofrojë-planifikojë infrastrukturë adekuate të transportit. Janë vetëm tri akset rrugore (rruga Mbretëresha Teutë, R107, dhe Gjeneral Ëesley Clark) që shërbejnë si rrugë mbledhëse urbane, pra e bartin të gjithë ngarkesën e komunikacionit në zonë dhe ofrojnë qasje në të gjitha lagjet. Rrjeti i rrugëve tjera lokale është i çrregullt, me profile të ndryshme, në disa raste shumë të ngushta, gjë që e kufizon qasjen dhe vështirëson qarkullimin.

Zona 2: Shërbimet tregtare – Zona e dytë (lagjet Rrokaqielli dhe Haxhi Zeka), Në krahasim me qendrën e qytetit, frekuentimi i këmbësorëve dhe veturave është më i ulët, përveç në akset kryesore (Mbretëresha Teutë, Bill Clinton, Adem Jashari dhe M9) që e bartin komunikacionin në drejtim të qendrës dhe jashtë qytetit. Përparësi e zonës është se pavarësisht nga profili i tyre i ngushtë, rrugët shfrytëzohen për lëvizshmëri të përbashkët të automjeteve, biçikletave, dhe këmbësorëve, duke promovuar njëkohësisht tre modalitete të transportit.

Zona 3: Banimi– Zona e tretë (lagja Dardania). Rrjeti i rrugëve në krahasim me të dy zonat tjera është i rregullt dhe me profil më të gjerë.

Zona 4:Biznesi dhe industria – Janë tre rrugë urbane mbledhëse (M9, R101, rruga e Birrarisë) dhe një rrugë urbane mbledhëse/lidhëse (rruga e transitit) të cilat e bartin komunikacionin në zonë dhe jashtë saj. [1]

3.2.Elementët themelorë të projektimit të udhëkryqevë rrethorë

Ato janë: [6]

- ✓ Shpejtësia
- ✓ Distanca e dukshmërisë(pamjes) dhe
- ✓ Madhësia (fluksi) i qarkullimit të automjetëve

Shpejtesia-për arsyje sigurie është shumë e rëndësishme që të pamundësohet që automjetët të kalojnë nëpër udhëkryqe rrethore me shpejtësi të mëdha.

Kjo duhet të evitohet nga një kombinim masash:

- ✓ Degët të jenë(afër) pingule me ishullin (rrethin) qendrorë,
- ✓ Rrezet në hyrjë dhe në dalje të udhëkryqit duhet të jenë sa më të vogla që është e mundur,
- ✓ Devijimet horizontale të jenë të mjaftueshme për automjetët në hyrjë të udhëkrqit

- ✓ Jo më shumë gjerësi të rrugëve rrethore sesa është e nevojshme për të akomoduar automjetët e vogla.
- ✓ Platformat e pjerrëta(apronet) të jenë të kalueshme që të zgjerohen ishujt qendror për automjetët e vogla etj.

Madhësia (fluksi) i qarkullimit të automjetëve:Për automjetët e mëdha duhet të mundësohet kalimi në udhëkryqin rrethor pa pasur nevojë për të kaluar mbi bordurë apo zona të ngritura

Distanca e dukshmërisë(pamjes)-është e rëndësishme të krijohen gjatësitë e duhura të dukshmërisë (pamjes) për:

- ✓ Automjetët që levizin në rreth
- ✓ Automjetët që kthehen në të majtë



Fig.3.3:Distanca e dukshmërisë(pamjes)[6]

3.3.Udhëkryqet më Rrethrrotullime

Udhëkryqet rrethore mund të trajtohen si një numër kryqëzimesh me prioritetë të thjeshta dhe me shirita qarkullues të ndërlidhur. Trafiku hyrës duhet tu jep përparësi kalimi trafikut që lëvizë në rreth dhe këmbësorëve,ndërsa trafiku dales duhet tu japë përparësi kalimi vetëm këmbësorëve,mundësisht edhe qarkullimit rrethot të biçikletavë. [5]

Në bazë të madhësisë së udhëkryqevë rrethore ekzistojnë këto lloje:

- Mini –udhëkryqe rrethorë,
- Udhëkryqet rrethore kompakte urbane,
- Udhëkryqet rrethore me një shirit urban,
- Udhëkryqet rrethore me dy shirita urban,
- Udhëkryqet rrethore me një shirit rural,
- Udhëkryqet rrethore me dy shirita rural

Të udhëkryqet rrethore dallohen këto elementë gjeometrike: [5],[6],[21]

- Ishulli (ose ndarësi) rrethor - është pjesa qendrore e udhëkryqit rrethor rrezja e të cilit varet nga madhësia e rrethit.
- Ishujt ndarës - janë ndarësit ndërmjet lëvizjeve së automjetëve në hyrje dhe në dalje.
- Rruga e qarkullimit rrethor – është hapësira (rruga) që përdoret nga automjetët që lëvizin në formë rrethore,
- Platforma speciale (aproni)- është një unazë(zonë) rrethore rreth ishullit qendror e cila përdoret vetëm prej automjetëve komerciale,
- Sinjalizimi horizontal në hyrje - janë vijat horizontale në hyrjë të udhëkryqit rrethor



Fig.3.4:Elementët gjeometrike të udhëkryqëve rrethorë[6]

Dimensionet e udhëkryqevë rrethorë duhet të garantojnë këto veçori : [5],[6],[21]

- Rrezen e mjaftueshmë për të zvogëluar shpejtësinë e automjetëve jo më shumë se 50km/h,
- Automjetët në hyrjë duhet të devijojnë paksa nga drejtimi i tyre dhe të zhvillojnë shpejtësi të vogla,
- Automjetët e mëdha duhet të përshtaten duke i përdorur hapësirat e përparme dhe hapësirat tjera të qarkullimit rrethor



Fig.3.5:Veçoritë e përmasave gjeometrike të udhëkryqevë rrethorë[6]

3.4.Përparësitë e rreth rrotullimëve

Rrethrrotullimet kanë vetëm 8 pika të konfliktit, 4 divergjentë (dalëse) dhe 4 konvergjentë (hyrëse) në vend të 32 pikave të konfliktit që ekzistojnë në udhëkryqet klasike. [5],[16]



Fig.3.6: Pikat konfliktuoze [6]

3.5.Koncepti i udhëkryqevë me sinjalizim

Qëllimet kryesorë të krijimit të udhëkryqit me sinjalizim janë dy kryesorë: [2]

- Ofrim të sigurisë për pjesmarrësit e trafikut,duke përfshirë shoferët,pasagjerët,kalimtarët,biciklistët.
- Ofrojë lëvizje më efikase të të gjithë pjesmarrësve të trafikut në udhëkryq.

Përparësit e kontrollit të udhëkryqit me sinjal-semafor nëse janë dizajnuar mirë,punojnë dhe mirëmbahen mirë janë: [2]

- Sinjalet e kontrollit të trafikut sigurojnë një lëvizje të rregullt të trafikut,pa pengesa të mëdha, në situate komplekse të trafikut.
- Rrisin kapacitetin e udhëkryqit ,e më këtë edhe nivelin e shërbimit ,nëse janë realizura sinjalizimet si duhet dhe plotësojnë kërkesen e trafikut.
- Ato mund të zvogëlojnë numrin e aksidentëve në rrugë si aksidenti i këmbësorëve dhe përplasja në kënd të drejtë të dy makinave.
- Treguesit e sinjaleve mund të shihen lehtësisht në mot me mjegull ose gjatë natës.

Mangësitë e kontrollit të udhëkryqit me sinjal-semafor nëse nuk dizajnohen mirë:[2],[3]

- Vonesa në qarkullim duke i ndalur mjetet në kryqëzim në orët e pikut.
- Rritja e bllokimit të trafikut, ndotja e ajrit dhe konsumi i karburantit
- Kostoja e sinjaleve të trafikut.
- Disa drejtues mjetesh nuk i binden këtyre sinjalistikave të trafikut,hyjnë në portokalli,në të kuqe ,përdorimi i rrugëve alternative për të shmangur sinjalistikën e trafikut etj.



Fig.3.7:Zgjedhja e tipit të udhëkryqit sipas rekomandimëve të Institutit Kommunförbundet.[3]

4. ANALIZA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË RRJETIN RRUGOR (NË RRUGËN "BEKIM BERISHA"E CILA LIDHË 3 UDHËKRYQET PËR SHQYRTIM) TË SHQYRTUAR DHE IDENTIFIKIMI I PROBLEMËVE.

Në këtë kapitull do të paraqesim gjendjen ekzistuese dhe identifikimin e problemëve që paraqiten të udhkryqet që kena marr për shqyrtim.Janë zgjedhur 3 udhëkryqe në qytetin e Pejës në rrugën "Bekim Berisha" ,M9 dhe R107 që janë të lidhura ndërmjet vete dhe formojnë rrjetin rrugor që është më i ngarkuari në këtë qytet.

Në figurën 4.4 është paraqitur segmenti i rrjetit rrugor i 3 udhëkryqevë të analizuar në qytetin e Pejës.Gjatësia e rrjetit rrugor "Bekim Berisha" dhe udhëkryqeve R107 dhe M9 është: L= 1.3 (km)

4.1.Udhëkryqi(U3) rrethor i rrugëve "M9", "Bekim Berisha" , "Rruga e Birrarisë" dhe rruga "Amir Morina"

Është udhëkryqi më i komplikuar pasiqë përveq formës rrethore me 4 hyrje apo degë, lidhet edhe më rrugen Amir Morina ,në rreth janë dy shirita dhe gjithashtu ekzistojnë edhe nga një shirit për ngasje në hyrje të udhëkryqit rrethor.Gjatesia e shiritave 3.5m



Fig.4.1: Rruga "M9" me rrugët" Bekim Berisha "Amir Morina dhe "Rrugën e Birrarisë"(Burimi: Google Maps)

4.2. Udhëkryqi (U2) i rrugëve “Bekim Berisha ” dhe “Ahmet Krasniqi”

Është udhëkryq i formës “T”, me nga një shirit për kahe të lëvizjes në dy degë kurse në degën e tretë ka dy shirta.Poashtu ky udhëkryq sikurse udhëkryqi U3 është mjaft I ngarkuar me qarkullim të automjetëve. Gjersia 3.5m



Fig.4.2: Rruga “ Bekim Berisha ”me rrugën “Ahmet Krasniqi”(Burimi:Google Maps)

4.3. Udhëkryqi i rrugëve “R107” “Bekim Berisha ” dhe rruga Dedë Krasniqi”

Është udhëkryq i formës rrethore me tri hyrje apo degë dhe një i formes T , në rreth jonë 2 shirita dhe gjithashtu ekzistojnë edhe nga një shirit për ngasje në hyrje të udhëkryqit rrethor në dy degë,kurse në degen e tretë është me dy shirita për ngasje në udhkryqin rrethorë.

Fig.4.3:Rruga "R107" me rrugën" Bekim Berisha dhe Ded Krasniqi"(Burimi:Google Maps)

Pas vëzhgimit vizual të segmentit rrugor Bekim Berisha janë vërejtur disa karakteristika në këtë segment rrugor, të cilat do ti paraqesim më poshtë:

- Mungesë të sinjalizimit horizontal përgjatë segmentit rrugor Ahmet Krasniqi, ku mungon vija e mesit e cila i ndan shiritat dhe e cila e përcakton të drejtën apo mos të drejtën e tejkalimit,
- Gjendja e jo e mire e mirëmbajtjes se vendkalimeve të këmbësoreve nëpër udhëkryqe ku gjendën aktualisht,
- Parkimi i automjetëve në udhëkryqe, skaj rrugëve e në trotuar, problematika e qasjes së këmbësoreve dhe hapësira e pamjaftueshme në trotuar për lëvizjen e tyre,
- Mungesë e sinjalizimit horizontal për stacionet e ndaljes së autobusëve,

Në vashdim do ti paraqesim vërejtjet e dhëna më lartë përmes fotove të marrura nga tereni.

Elementi i parë: Mungesa e sinjalizimit horizontal përgjatë segmentit rrugor Ahmet Krasniqi.



Fig.4.4:Mungesa e sinjalizimit horizontal –vija e plotë rruga Ahmet Krasniqi

Elementi i dytë: Mungesa e vendkalimeve të shënuar për këmbësor udhëkryqi U2



Fig.4.5:Mungesa e vendkalimëve të shënuar për këmbësorë të udhëkryqet e analizuar

Elementi i tretë: Gjendja e jo e mire e mirëmbajtjes se vendkalimevë të këmbësoreve në udhëkryqet ku ekzistojnë aktualisht.

Fig.4.6:Gjendja ekzistuese e vendkalimëve të këmbësorevë

Elementi i katërt: Parkimi i automjetëve në udhëkryqe, në skaj të rrugëve e në trotuar, hapësira e pamjaftueshmë në trotuar për lëvizjen e këmbësorëve

Fig.4.7:Automjetët e parkuara në vende të ndaluara

Fig.4.8:Automjetët e parkuara në vende të ndaluara dhe në trotuar

5. IMPLEMENTIMI I TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË UDHËKRYQE DHE FUTJA E TYRË NË SOFTUERIN SYNCHRO 10.0

Pas marrjes së të gjitha të dhënave nga udhëkryqet dhe vendosjes së tyrë në softuer, ku fillimisht modelohet rrjeti rrugor i cili është trajtuar me të gjitha parametrat e nevojshëm për analizë sa më profesionale. Pas modelimit bëhet simulimi i trafiku në tërsi i segmentit rrugor, passimulimit dhe inçizimit të trafikut ,bëhet nxjerrja e rezultatëve që fitohen për parametrat e trafikut për gjendjen ekzistuese.

5.1 Softueri i përzgjedhur për analizë (Synchro 10.0).

Softueri Synchro 10.0 është një softuer Amerikan mjaft i përsosur dhe shërben për rregullimin e qarkullimit,kalkulimin dhe vlersimin e kapacitetit dhe nivelit të shërbimit në udhëkryqe. Ky softuer bazohet në elementë gjeometrike dhe në të dhënat e numrit të automjetëve të cilat frekuentojnë në atë segment rrugor. Po ashtu softueri bazohet edhe në mënyrën e rregullimit të qarkullimit në nyje rrugore. Fillimisht modelohet rrjeti i trafikut, pastaj vendosen të dhënat për numrin e automjetëve dhe bëhet përshtatja e rregullimit të qarkullimit të nyjeve përgjatë segmentit rrugor. Pastaj bëhet simulimi i trafikut duke realizuar inçizime kohore të ndryshme që zakonisht janë për 15 minuta, apo për një orë 1(h) = (4 x 15 min.). Pasi përfundon edhe inçizimi të cilin e përcaktojmë ne atëherë mund edhe ti nxjerrim raportet të cilat paraqesin përformancen në përgjithësi të rrjetit rrugor. Është I përbërë nga tri pjesë kryesore: [4],]15],[2]

- ✓ **Synchro Studio**-mundëson realizimin e modelit të udhëkryqit dhe analizat makroskopike.
- ✓ **Sim traffic** –mundëson simulimin e lëvizjes së pjesmarrësve në udhëkryqin e modeluar paraprakisht në synchro ,realizon analiza makroskopike dhe mikroskopike.
- ✓ **3D Viewer 10**-Paraqitja dhe animacioni në pamjen 3D.

Në figurën 5.0. kemi paraqitur parametrat që do të analizojmë:



Fig.5.0:Karakteristikat e marrura në trajtim [5],[7]

5.2. Të dhënat për qarkullimin e automjetëve në segmentin rrugorë të mbledhura në terren

Mbledhja e të dhënave në terren është realizuar në 7 ditë të ndryshme të javës, në mënyrë që të shohim se në cilën ditë është rrjeti më i ngarkuar dhe të analizojmë për atë periudhën kohore që rezultatet të jenë sa më reale dhe analiza të jetë sa më e arsyeshme.

Tab.5. 1: Orari i numërimevë

Data	Dita e javës	Ora		
20.05.2021	**E Hënë**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
21.05.2021	**E Marte**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
22.05.2021	**E Mërkurë**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
23.05.2021	**E Enjte**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
24.05.2021	**E Premte**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
25.05.2021	**E Shtune**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00
26.05.2021	**E Diele**	7:00-8:00	12:00-13:00	16:00-17:00

5.3. Mënyra e numërimit dhe e mbledhjes së të dhënave

Numërimi është bërë për secilën hyrje të segmentit për secilën ditë të javës nga dita e hënë deri në ditën e dielë. Pastaj për cilën ditë është evidentuar numër më i lartë i automjetëve për hyrje në segmentin e trajtuar është marrur për trajtim, në vashdim do ti paraqesim numërimet për secilin shirit dhe për secilin udhëkryq të cilat do të shfrytëzohen për llogaritjen e jolinetaritetit të qarkullimit

Pikat hyrëse për rrjetin rrugor të shqyrtuar janë prezantuar në figurën 5.1

Fig.5.1:Pikat hyrëse në rrjetin rrugor të trajtuar(Burimi:Gjeoportal Kosova)

Tab.5. 2: Numërimet fillestare për ditën e hënë

Madhësia e qarkullimit q$(aut/15min)$				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesavë
Hyrja	H1	H2	H3	
E Hënë (PD)	525	438	557	
E Hënë (GJD)	377	458	479	
E Hënë (MD)	449	462	500	
Gjithsejtë$[AU/15min]$ E Hënë	**H1+H2+H3**			
PD=(7:00-8:00)	**1520**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**1314**			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	**1411**			MD=MBASË DITË



Fig.5.2: Numërimet për ditën e hënë

Tab.5. 3:Numërimet fillestare për ditën e martë

Madhësia e qarkullimit q$(aut/15min)$				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sçarimet e shkurtesavë
Hyrja	H1	H2	H3	
E Martë (PD)	380	303	602	
E Martë (GJD)	336	249	462	
E Martë (MD)	380	338	519	
Gjithsejtë$[AU/15min]$ E Hënë	**H1+H2+H3**			
PD=(7:00-8:00)	**1285**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**1047**			GJD=GJATË DITES
MD=(16:00-17:00)	**1237**			MD=MBASË DITË



Fig. 5.3:Numërimet për ditën e martë

Tab.5. 4: Numërimet fillestare për ditën e mërkurë

Madhësia e qarkullimit q$(aut/15min)$				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesave
Hyrja	H1	H2	H3	
E Merkurë (PD)	389	305	530	
E Merkurë (GJD)	400	369	498	
E Merkurë (MD)	430	414	537	
Gjithsejtë $[AU/15min]$ E Merkurë	H1+H2+H3			
PD=(7:00-8:00)	1224			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	1267			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	1381			MD=MBASË DITË



Fig.5.4:Numërimet për ditën e mërkurë

Tab.5. 5: Numërimet fillestare për ditën e enjtë

Madhësia e qarkullimit q($aut/15minuta$)				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesave
Hyrja	H1	H2	H3	
E Enjtë (PD)	350	295	532	
E Enjtë (GJD)	300	255	400	
E Enjtë (MD)	360	350	490	
Gjithsejtë[$AU/15min$] E Enjtë	**H1+H2+H3**			
PD=(7:00-8:00)	**1177**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**955**			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	**1200**			MD=MBASË DITË



Fig. 5.3:Numërimet për ditën e enjtë

Tab.5. 6: Numërimet fillestare për ditën e premtë

Madhësia e qarkullimit q($aut/15min$)				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesave
Hyrja	H1	H2	H3	
E Premtë (PD)	495	300	500	
E Premtë (GJD)	450	349	465	
E Premtë (MD)	480	387	492	
Gjithsejtë[$\boldsymbol{AU/15min}$] E Premtë	**H1+H2+H3**			
PD=(7:00-8:00)	**1295**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**1264**			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	**1359**			MD=MBASË DITË



Fig.5.6:Numërimet për ditën e premtë

Tab.5. 7: Numërimet fillestare për ditën e shtunë

Madhësia e qarkullimit q(aut/h)				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesave
Hyrja	H1	H2	H3	
E shtunë (PD)	515	389	542	
E shtunë (GJD)	327	346	422	
E shtunë (MD)	414	441	570	
Gjithsejtë$[AU/15min]$ E shtune	H1+H2+H3			
PD=(7:00-8:00)	**1446**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**1095**			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	**1425**			MD=MBASË DITË



Fig.5.7:Numërimet për ditën e shtunë

Tab.5. 8: Numërimet fillestare për ditën e dielë

Madhësia e qarkullimit q(aut/h)				
Kahja e levizjes	Majtas (q_m)+Drejt (q_d)+Djathtas (q_{dj})			Sqarimet e shkurtesave
Hyrja	H1	H2	H3	
E Dielë (PD)	200	295	315	
E Dielë (GJD)	260	320	334	
E Dielë (MD)	300	370	382	
Gjithsejtë$[AU/h]$ E Dielë	**H1+H2+H3**			
PD=(7:00-8:00)	**810**			PD=PARADITË
GJD=(12:00-13:00)	**914**			GJD=GJATË DITËS
MD=(16:00-17:00)	**1052**			MD=MBASË DITË



Fig.5.8:Numërimet për ditën e dielë

Tab.5. 9: Numri total i automjetëve gjatë ditëve të javës

Nr. total i automjeteve për të 3 periudhat (7:00-8:00+12:00-13:00+16:00-17:00)						
Dita e hënë	Dita e martë	Dita e mërkurë	Dita e enjtë	Dita e premtë	Dita e shtunë	Dita dielë
4245	**3569**	**3872**	**3332**	**3918**	**3966**	**2766**



Fig.5.9: Jolineariteti javorë

6.MODELIMI DHE SIMULIMI I RRJETIT RRUGOR MË SOFTUER SYNCHRO 10.0

